



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

Nr. Prot

Tirane, me 10/ 03 /2017

FTESE NEGOCIM

Per: Ata qe intersohen

Instituti i Shendetit Publik kerkon te realizoje procedure per **Blerjen e spoteve publicitare dhe transmetimin te mediave vizive dhe te shkruar te fushates sensibilizuese "Ndërgjegjësimi i popullatës për Autizmin ,**

Ju lutemi kerkojme te na vini ne dispozicion te ofertes tuaj per sherbimin e kerkuar sipas specifikimeve si dhe percaktimeve ne tabelen e meposhtme:

"Blerjen e spoteve publicitare dhe transmetimin te mediave vizive dhe te shkruara te fushatave sensibilizuese per Vitin 2017:

Objekti i spoteve do të jetë: **"Fushatë ndërgjegjësimi lidhur me 2 Prillin, Ditën Botërore të Autizmit dhe Muajin Prill, Muaji i Ndërgjegjësimit për Autizmin".**

Nevoja e kryerjes se fushtës prodhimi i spotit dhe sherbim i transmetimit te tyre eshte:

-Autoriteti yne kontraktor në kuadër të "Edukimit shëndetësor dhe promovimit për një shëndet të mirë, përfshirë e shëndetin mendor pozitiv, kërkon të realizojë **fushatën ndërgjegjësuere e cila vjen në kuadër të 2 Prillit, Dita Botërore të Autizmit dhe Muajin Prill, Muaji i Ndërgjegjësimit për Autizmin. Kjo është një ditë** e vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe synon përqëndrimin e vëmendjes së të gjithë shoqërisë tek çrregullimet e spektrit autik, të rrisë ndërgjegjësimin e popullatës lidhur me autizmin, të shtojë sensibilizimin e opinionit publik për ofrimin e përkrahjes së nevojshme për këta fëmijëve integrimin e tyre në shoqëri.

Formulari I ofertes

Nr	Pershkrimi I sherbimeve	sasia	Cmimi /njesi	Cmimi /Total	AFATI
PRODHIMI					
1	<i>Prodhim spoti (1 spote me teme Ndërgjegjësimi i popullatës për Autizmin)</i>	1			JO ME SHUME SE 5 DITE nga lidhja e kontrates dhe Kohezgjatja e transmetimit te spotit jo me pak se 30 sekonda
TRANSMETIMET					

2	<i>Transmetim spotit (Ndërgjegjësimi i popullatës për Autizmin) ne 2 TV te ndryshme kombetare</i>	58			02 -Prill -30 Prill me tematike " Ndërgjegjësimi i popullatës për Autizmin " (1 spote/dite/ ne dy TV kombetare te ndryshme) ne fashat orare 12:00 - 15:00 ne njerin TV dhe 15.00 - 18.30 ne TV tjeter
	Cmimi neto				
	TVSH(%)				
	Cmimi TOTAL				

1. Spoti do te prodhohet brenda 5 diteve nga lidhja e kontrates
2. Koha e shperndarjes te spoteve ne TV do te jete ne fashat orare nga 12.00-15.00 ne njerin TV dhe dhe 15.00 deri me 18.30 ne TV tjeter

Fondi Limit eshte 1 467 200 (Njemilion e katerqind e gjashtedhete e shtatemije e dyqind) Leke, vene ne dispozicion nga Buxheti i Shtetit 2017 .

I. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:
Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
 - b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 1 "Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore", bashkangjitur fteses

Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, do të paraqitet vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore , te lëshuar nga Administrata Tatimore.
3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në te cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit te lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Keto kritere (pikat 1,2,3) duhet te vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës

4. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit (sipas formatit bashkangjitur shtojca 2)

II. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Xhiroja mesatare e tre viteve të fundit te ketë një vlere sa fondi limit. Për ketë operatori ekonomik duhet te paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit.
2. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. Te jete paguar Muaji Janar 2017

III. Kapaciteti teknik:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin projekt – ide për mënyrën e realizimit të spotit, dhe permbajtjen e tij
2. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale te operatorit ekonomik:
 - 2.1 CV te shoqërisë dhe te stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës.

Kushte specifike

1. Te dale i qarte qellimi i berjes se fushates ne realizimin e spoteve .
2. Te jete i qarte dhe sa me shume sensibilizues (per target grupin qe ze)
3. Koha e spotit televiziv te jete jo me pak se 30 sekonda
4. Te permbaje ze dhe figure
5. Te jete qarte dhe dukshem ne spot logoja dhe sllogani i fushates sensibilizuese e shoqeruar gjithmone me logon e ISHP ne fund te cdo spoti.
6. Operatori ekonomik gjatë realizimit të spotit do të jetë në konsultim të vazhdueshëm me ekipin e caktuar nga ISHP.
7. Numeri i transmetimeve te jete jo me pak se 1 transmetim ne dite per cdo TV kombetar, 02 Prill-30 Prill me shperndarje (1 spote/dite/ ne seicilin TV) me tematike ***Ndërgjegjësimi i popullatës për Autizmin***, ne fashat orare 12:00 - 15:00 ne njerin TV dhe 15.00 - 18.30 ne TV tjeter
8. Te transmetohen jo me pak se ne dy media kombetare.
9. Buxheti te paraqitet I vecante dhe I detajuar si per realizmin e spoteve dhe per transmetimin ne media dhe per shperndarjen e transmetimeve qe institucioni I intersuar te gjeje menyren efikase per monitorimin e tyre, bazuar ne formularin e nje media planit te paraqitur nga ofertuesi.
10. Te paraqitet nje projekt ide-skenar per realizimin e spotit me tematiken e mesiperme
11. Ana grafike dhe regjisoriale e spotit dhe cdo element i tij duhet te jete ne perputhje me rregullat e pergjithshme te vendimit nr.1195 dt 05.08.2008

Per me shume informacione mund te gjeni ne Faqen e ISHP-se , me adrese www.ishp.gov.al
 Per informacione te metejshme ose per paqartesi ju lutem kontaktoni ne adresen e kontaktit:
 nr.tel: +35542374756,04 2375723
 nr.fax +35542370058
 e-mail: albana.ahmeti@ishp.gov.al

Kjo procedure do te kryhet mbi bazen e VKM-se Nr.1195 , date 05/08/2008 “Per blerjen zhvillim , prodhimin dhe bashkeprodhimin e programeve a te reklamave per transmetim nga operatoret radiotelevezive ose botim ne median e shkruar dhe per kontrata , per kohe transmetimi , nga organet e Administrates Shtetesore”

Cdo organ i masmedias /Agjensi e specializuar ftohet te dorezoje oferte. Kontrata do ti akordohet atij organi qe ka dorezuar oferten e vleresuar si me e mira, bazuar ne kriteret e percaktuara ne kete dokumentacion dhe ne baze VKM nr.1195 dt.05/08/2008, neni 7 si më poshtë

1. Organi i masmedias/ Agjensia e specializuar, për plotësimin e Kriereve te pergjithshme te kualifikimi , dokumentacionit ligjor , kapacitetin ekonomik dhe finciar, kapacitetin teknik perfshire projekt idene realizimit te spotit, *me 30 pike.*
2. Cmimi i ofruar, vleresohet me *60 pike.*
3. Koha e transmetimit të spotit *10 pike*

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - jane pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - jane pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min}k1 \times P_{max}k1 / Ok1$$

Pk1 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{min} k1 Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{max}k1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Organet e mass medias ose agjensite e specializuar duhet te dorezojne oferten origjinale si dhe dokumentazioni e kerkuar me siper(kerkesate e pergjithshme) te futur ne nja zarf jotransparent , te mbyllur , te vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresen e ofertuesit dhe te shenuar oferte per kryerje e sherbimit **Blerjen e spoteve publicitare dhe transmetimin te mediave vizive te fushates sensibilizuese “ Ndërgjegjësimi i popullatës për Autizim ”** Mos e hapni me perjashtim te rasteve kur eshte i pranishem Komisioni dhe jo para dt. 20/03/2017, ora 11.00

Oferta ekonomike duhet te paraqitet sipas formularit te mesiperme, ku te specifikohen saktesisht nga operatori ekonomik ofertues se cilat jane, mediat kombetare.

Afati kohor per dorezimin e ofertave , si dhe per zhvillimin e negozimit ne lidhje me proceduren me objekt “Blerjen e spoteve publicitare dhe transmetimin te mediave vizive te fushates sensibilizuese “ **Ndërgjegjësimi i popullatës për Autizim** ”eshte me dt. 20/03/2017, ora 11.00, prane ISHP_Se, ne zyren e nendrejtorit ekonomik te ISHP-se, kati i pare pasi te jete protokolluar

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negocim.

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

V ula

Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË

Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një

njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula